



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 27

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303

Prishtinë, më 15 mars 2016, në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Adem Hoxha dhe Bekim Haxhiu.

Munguan: Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Imet Rrahmani, ministër i Mistrisë së Shëndetësisë, Ramadan Halimi, këshilltar - MSH, Hekuran Murati- Ministria e Financave, Ardian Mehmetaj – MSH, Arsim Qavderbasha - MSH, Sanije Berisha – OSBE, Genc Jaha - KDI dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportimi i ministrit të Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani:
 - Marrëveshja e kredisë Kosovë - Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK.
 - Memorandumi i Mirëkuptimit, midis Zyrës së Presidentit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, afrimi i Shërbime shëndetësore falas për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës;
3. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Raportimi i ministrit të Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani:

Marrëveshja e kredisë Kosovë - Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK.

Kryetarja e përshëndeti ministrin dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe përfaqësuesin e Ministrisë së Financave. Të gjithë u ndiem keq që Marrëveshja e kredisë së butë Kosovë – Austri e cila është nënshkruar gjatë vizitës së presidentit austriak në Kosovë nuk i mori votat e nevojshme në Kuvend, që të ratifikohet edhe pse ishte një mundësi e mirë për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore, sidomos në sektorin shumë të ndjeshëm kardiologjia invazive. Vërejtjet që janë paraqitur në seancë kanë qenë për arsye të çmimit të lartë për blerjen e aparaturave, si dhe a ka pasur konkurrencë në procedurat e konkurrimit? Natyrisht vërejtja ka pasur edhe për sallën hibride, si dhe jo transparencën ndaj Komisionit Parlamentar për Shëndetësi. Po ashtu periudha prej dyjavësh që ka ofruar operatori për trajnimin e stafit lidhur me aftësimin për përdorim të aparaturave edhe kjo është një çështje që duhet të diskutohet. Pra këto janë disa nga dilemat që te deputetët sollën dilema dhe marrëveshja nuk i mori votat e nevojshme që të ratifikohet. Po ashtu po ju njoftoj se kam pasur një takim me Ambasadorin e Austrisë, z. Pfandler, i cili më ka njoftuar se sa i përket procedurës së prokurimit është përfunduar çdo gjë. Ndoshta është një debat i vonuar, mirëpo nga ju, z. Ministër, kërkojmë që të na prezantoni arsyen tuaj lidhur me vërejtjet që i dëgjuat dhe për të cilat kjo marrëveshje nuk u ratifikua në Kuvend. Ju faleminderit, z. ministër e keni fjalën!

Imet Rrahmani – Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë- Ju faleminderit e nderuara kryetare, të nderuar deputetë, përshëndetje për ju të pranishëm. Po ashtu edhe ne shprehim keqardhjen e madhe si ministër që marrëveshja nuk është ratifikuar jo në mbledhjen kur është votuar, por që nuk është ratifikuar në dhjetor 2015, sepse mos ratifikimi i kësaj marrëveshje ka shkurtuar buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë -MSH edhe ashtu të vogël për 2.6 milionë euro. Pra, ato mjete kanë shkuar në suficit. Siç e thatë edhe ju, marrëveshja është realizuar konform marrëveshjes së më hershme që është lidhur mes Qeverisë së Kosovës dhe asaj austriake, respektivisht ndërmjet dy ministrive të Financave në vitin 2012. Sipas kësaj marrëveshje brenda tri vjetëve kjo mundësi, kjo kredi e butë të implementohej dhe huamarrja prej 20 milionëve e dakorduar atëherë të shpenzohej. Në vitin 2015 buxheti i paraparë për njësitë që kanë përfituar nga kjo kredi do duhej të parashihet në ligjin e buxhetit dhe meqenëse kjo deri në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015 nuk është arritur atëherë në vitin 2015, është paraparë buxheti për përfitimin e Ministrisë së Shëndetësisë në vlerë prej 4.6 milionë euro. Do të prezantoj me radhë të gjitha çështjet që u ngritën!

Kur është përfituar kjo kredi e butë 4.6 milionë euro, është vlerësuar që ka nevojë sistemi jonë shëndetësor që të investohet në një sallë hibride dhe kanë filluar procedurat e blerjes së sallës hibride dhe në pjesën e dytë të vitit 2014 është hequr dorë nga ai proces. Salla hibride, procedurat gjithashtu janë zhvilluar në Austri. Është hequr dorë nga ky proces se një nga arsyet ka qenë që

ekspertët kanë vlerësuar se sistemi jonë shëndetësor nuk ka nevojë në këtë fazë të blejë sallë hibride, ngase nuk e kemi kardiokirurgjinë funksionale, por kemi nevojë që ato mjete të shpenzohen në investime të tjera, në blerje të aparaturës më konkrete dhe që do të hyjnë në përdorim menjëherë nëpër reparte të caktuara ku do të investohet. Diku në fillim të vitit 2015 kjo çështje është ngritur nga deputeti, z. Haxhiu, dhe ne kemi dhënë sqarimet e nevojshme pse të mos blihet sala hibride, por këto mjete të shfrytëzohen për modernizimin e kardiokirurgjisë invazive dhe kardiokirurgjisë si dy njësi të pandara që i kanë munguar sistemit tonë shëndetësor. Në ligjin e buxhetit kanë qenë të parapara 2.6 milionë euro në organizatën buxhetore Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës -SHSKUK në bashkëpunim me Ministrinë e Financave-MF dhe Ambasadën e Austrisë dhe në kontaktet me shtetin austriak i kemi njoftuar me ndryshimin e destinimit të projektit të mos blejmë sallë hibride, por të blejmë aparaturë tjetër. Me kërkesën tonë drejtuar Ministrisë së Financave në rishikim të buxhetit, pasi që SHSKUK në vitin 2015 nuk ishte i përgatitur dhe nuk ndërmoi asnjë hap për shfrytëzimin e kësaj vlerë prej 2.6 milionë euro. Ne, në rishikim të buxhetit, kërkuam që të kthehen në MSH dhe t'i fillojmë procedurat e përsheptuese të kontraktimit të aparaturës e cila do të blihet, varësisht prej nevojës çfarë i kemi dhe këto mjete në rishikim të buxhetit janë kthyer në menaxhim të MSH-së me pëlqimin edhe të SHSKUKS-së. Pasi që ishte një periudhë me pak se 6 muaj dhe për të mos kaluar në suficit këto mjete ne i kemi filluar procedurat në bashkëpunim me MF duke ju drejtuar partnerëve austriakë - huadhënësve që t'i fillojnë procedurat e blerjes së aparaturës. Lista të cilën ju kemi prezantuar është përgatitur nga ekspertë shëndetësorë, ku kanë qenë drejtori i kardiokirurgjisë invazive, drejtori i përgjithshme i SHSKUK-së, kryesuesi i Bordit të SHSKUK-së dhe përfaqësuesit e MSH-së, natyrisht që kemi qenë të involvuar edhe ne. Kjo është lista e pajisjeve, një Angiografi, një pallompomp intraortike, një Ultrazë për Kardiologji dimensional, një stacion, punë për vlerësimin e ultrazërave që bëhen brenda hapësirave të kardiologjisë, aparat ekstrakorporal për kardiokirurgji, tetë sisteme monitorimi për një monitorim qendror të sistemit të kardiokirurgjisë, pesmaker i jashtëm, EKG për monitorim 24 orë, dhe ultrazë i kraharorit të gjirit.

Kjo marrëveshje apo kjo kredi e butë na obligon që ne të blejmë diku 50 % nga shteti austriak. Ne nuk kemi pasur mundësi që të fusim në konkurrencë edhe operatorë jashtë shtetit austriak, sepse në nenin 8 të marrëveshjes rregullohet kjo çështje. MSH së bashku me MF kemi autorizuar Agjencinë për Inxhenering dhe të shëndetësisë austriake e cila ka zhvilluar të gjitha procedurat e blerjes, respektivisht kontraktimit të këtyre aparaturave. MSH në këtë fazë ka qenë vetëm si vëzhgues oferta e fundit ka qenë 2.1 milionë, ndërsa 490. 000.00 euro janë për shërbime shtesë, shumë e cila është ofruar në momentin e fundit nga operatori ekonomik, i cili e ka fituar tenderin, këtu përfaqësuesi i Ministrisë së Financave besoj se do të na njoftojë me saktë. Ne kemi shprehur shqetësimin tonë se sa ka bazë ligjore që në momentin e fundit të inkorporojmë në marrëveshje këtë shumën 490. 000.00 € dhe në marrëveshjen që e kemi nënshkruar para Presidentit të Austrisë dhe Presidentes tonë ekziston një nen i cili parasheh se kjo vlerë duhet të analizohet nga aspekti ligjor dhe mandej të implementohet. Kjo shumë ka të bëjë për trajnim dyjavor për përdorim të aparaturës, është për zgjatje të garancisë dhe për mirëmbajtje dhe për rregullimin e hapësirave, ku ka me u vendosur aparatura. Sa i përket hapësirave ku ka me u vendosur kjo aparaturë në bazë të dispozitave ligjore të prokurimit të Austrisë, kanë pasur të drejtë që t'i vizitojnë këto hapësira dhe njeri nga këta operatorë ka ardhur i ka vizituar këto hapësira dhe ka ofertuar. Banka Qendrore e Austrisë nuk është e interesuar që të japë hua ose kredi për projekte të cilat nuk janë funksionale, andaj oferta e fundit për mirëmbajtje, garancinë dhe rregullimin e hapësirave që i garanton edhe implementim dhe

qëndrueshmëri të projektit ka qenë njeri nga kushtet për me u proceduar projekti përpara. Po ashtu ne kemi pasur kontakte të vazhdueshme me Ambasadën dhe shtetin e Austrisë dhe na kanë dhënë garancinë se të gjitha procedurat janë zhvilluar konform dispozitave ligjore. Pra, këto janë sqarimet tona në aspektin kronologjik, ndoshta kemi lëshuar ndonjë informatë, po ne jemi të gatshëm në bazë të pyetjeve apo interesit tuaj të ju njoftojmë. Ju faleminderit!

Kryetarja tha se unë kam një pyetje. Thatë se Kosova ka marrë pjesë vetëm si vëzhguese e procesit të kontratës me kompaninë VAMED, e cila përpos ofertës ma të volitshme ishte ofertuese dhe propozues për ofertën shtesë për garancinë për 24 muaj? Procedura e prokurimit është realizuar nga kompania AHC me seli në Vjenë, ndërsa ministria vetëm ka qenë vëzhguese. A mendoni që kjo që të jeni vetëm në cilësinë e vëzhguesit, a është në rregull? Çmimi për përgatitjen e sallës në bazë të diskutimeve si në seanca, po edhe këtu në mbledhje na është dukur i lartë, këtu ka qenë shqetësimi!

Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë- Më lejoni që të ju njoftoj se sponsorizuese e kësaj marrëveshje është Ministria e Financave – MF. Ne, si MSH, jemi vetëm përfitues dhe për negocimin e çmimeve përfaqësuesi i MF-së besoj se më hollësisht do të na njoftoj. Sa i përket çmimeve, sipas marrëveshjes së më hershme, na ka obliguar neve që të blejmë pajisje nga Operatorët austriak.

Hekuran Murati, përfaqësues i Ministrisë së Financave- Ju faleminderit! Siç e përmendi edhe ministri kemi të bëjmë me një marrëveshje kornizë për kredi, e cila është nënshkruar në vitin 2012 në vlerë prej 20 milionë euro ndërmjet Ministrisë së Financave të Kosovës dhe Ministrisë së Financave të Austrisë. Kjo marrëveshje Ndërkombëtare është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në bazë të kësaj marrëveshje kornizë parashihen dy metoda për tenderimin se prokurimit të shërbimeve që financohen nga kjo kredi, në bazë të kësaj marrëveshje parashihet që të paktën 50 % të shërbimeve, pajisjeve të blihen nga Austria. Marrëveshja, pra parash dy metoda të prokurimit të shërbimeve ose blerjes së pajisjeve, njëra metodë e prokurimit është përmes tenderimit ndërkombëtar në Austri, metode të cilën e ka zgjedhur ministria në këtë rast metoda tjetër e prokurimit është e negocimit direkt. Ne në këtë rast po flasim për dy marrëveshje pas kësaj është marrëveshja e furnizimit e cila është tenderuar. Pra është negociuar prej MSH-së dhe është marrëveshja e kredisë e cila negociohet dhe finalizohet me Bankën financuese e cila ka garancinë nga Banka Qendrorë e Austrisë. Ne, si MF, kemi negociuar marrëveshjen e kredisë me kërkesë të MSH-së, kemi pranuar kërkesën me vlerë 2.6 milionë € e cila ka qenë edhe e buxhetuar brenda ligjit të Buxhetit. Ne i kemi zhvilluar negociatat me përfaqësuesit e bankës financuese Unicredit Bank Austria AG. Këto negociata janë përmbyllur dhe është përcaktuar mënyra e tërheqjes së mjeteve kushteve të pagesave për sa këste, norma e interesit, kushtet e kredisë janë të volitshme. Kurse të marrëveshja e furnizimit përgjegjës është MSH-ja. Ne s'mundemi të ndërhyjmë në çështje teknike rreth produkteve, të cilat kanë qenë nevojat e tyre, apo çmimit të produkteve. Kjo është në mënyrë kronologjike, nëse keni ndonjë pyetje, urdhëroni! Ju faleminderit!

Kryetarja- Ne në këtë rast po diskutojmë në dy aspekte, në aspektin politik-diplomatik, sepse të refuzosh një marrëveshje apo kredi të butë nga një shtet mik i cili vazhdimisht ka qëndruar pranë nesh dhe na ka ndihmuar në sektorë të ndryshëm, konsideroj se është një gabim diplomatik. Dhe në anën tjetër dëmi material që mund të jetë i buxhetit të Kosovës sepse këto mjete qofshin edhe kredi

të buta ne duhet t'i paguajmë. Pra, kjo është dilema që e solli marrëveshjen që të mos votohet. Tash e kaloj fjalën te deputetët nëse kanë ndonjë pyetje. Urdhëroni Njomza, nënkryetare e komisionit!

Njomza Emini- Faleminderit kryetare. Fillimisht me lejoni që të ju falënderoj, z. Ministër dhe ju përfaqësues të ministrisë, që ju keni përgjigjur pozitivisht ftesës së komisionit. Ministër, pa dashur të përsëritet, siç e potencoi edhe kryetarja e komisionit, është një dëm diplomatik. Dëshiroj të di se ju, si Ministri, a e keni analizuar mundësinë e rikthimit të kësaj marrëveshje për ratifikim në Kuvend, ku normalisht që Kosova ka humbur shumë në modernizimin e kardiokirurgjisë invazive? Unë mendoj që është një humbje e madhe për shëndetësinë, por në radhë të parë për Kosovën si shtet siç u tha, ne kemi edhe vazhdojmë të kemi raporte dhe bashkëpunim shumë të mirë me Austrinë. Faleminderit!

Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë- Tha se, ne, ende nuk jemi takuar me ministrin e MF-it për të diskutuar hapat e mëtejshëm, një që mund të theksoj se si Qeveri jemi të interesuar që të rikthejmë në Qeveri dhe në Kuvend për ratifikim të kësaj marrëveshje. Mirëpo mbetet vetëm ta analizojmë procedurën ligjore. Siç e thatë edhe ju, konsiderojmë se realizimi i kësaj marrëveshje dhe blerja e kësaj aparature, krahas funksionalizimit që e kemi tash në kondita të kënaqshme kardiokirurgjinë të funksionalizojmë edhe shërbimin e kardiokirurgjisë invazive 24 orë! Kjo është edhe nevojë e kohës, por është edhe përpjekje e jona që këto dy shërbime kardiologjinë edhe kardiokirurgjinë në të ardhmen, me një vendim të Qeverisë, i cili pritet që të nxirret shumë shpejt do të trajtohen si shërbime me rëndësi të veçantë, sepse po na kushton shumë nga buxheti për trajtimin e këtyre pacienteve jashtë vendit, por edhe shumë qytetarë të Kosovës po detyrohen që të marrin këto shërbime në klinikat private brenda dhe jashtë Kosovës. Po ashtu është njëri nga prioritetet e MSH-së, respektivisht të Qeverisë funksionalizimi edhe i kardiologjisë dhe i kardiokirurgjisë invazive.

Fikrim Damka- Faleminderit! E nderuara kryetare, i nderuar z. ministër, të nderuar kolegë deputetë. Për sqarim, me sa e kam kuptuar në kemi marrë një kredi të butë nga Austria, diku 20 milionë €, MSH-ja ka përfituar 4.6 milionë €, ku 2.6 milionë do të përdorën për kardiokirurgji. Ju nuk e keni caktuar shumën se sa do të përdorët, mirëpo vetëm specifikacionin teknik të pajisjeve se cilat janë nevojat. Ju e keni përcjellë specifikacionin për pajisjet, kurse Agjencia Austriake për Shëndetësi dhe Inxhiniering – AHC, i ka zhvilluar procedurat e prokurimit. Sipas jush procedurat janë zhvilluar mirë dhe ka pasur konkurrencë mes operatorëve dhe ju si MSH keni qenë vetëm në cilësinë e vëzhguesit.

Pyetje: A i keni vlerësuar ju specifikacionin teknik apo pajisjet me çmimin real të tregut?

Me qëllim që t'i krahasojmë çmimet reale të tregut me ofertën e operatorit ekonomik VAMED të paktën bile me analizuar se oferta, a është e afërt me çmimin e tregut diku 10 deri 15 % të përafërta. Një analizë të tillë, a keni ju si MSH? Pasi që me sa kuptova, ju nuk keni pasur mundësinë e negociimit të çmimeve.

Pyetje: Pse nuk është përdorë procedura e prokurimit e negociimit të çmimit?

Pyetje: A e kemi specifikacionin me çmimet prej operatorëve e tjerë?

Me sa kemi parë pajisjet janë të prodhuesit botërore Philips, a i keni bërë ju një analizë me çmimet e operatorëve të tjerë dhe a e keni shprehur shqetësimin se ne nuk jemi në gjendje për të pranuar këtë ofertë me këtë çmim shumë të lartë? Apo vetëm keni pasur qëllimin modernizimin e shërbimeve të

kardiokirurgjisë. Po ashtu, me sa e di, edhe me herët diku 1.8 milion € investim nga Italia, keni përdorë për funksionalizim të kardiokirurgjisë, para një kohe diku tre ose katër muaj ka nisur të funksionojë. Me sa e kam parë ka pas oferta edhe ma të lira një 1.4 milion €, një ofertë tjetër 1.3 milion €, për specifikacionin e njëjtë.

Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë- Tha se lista e aparaturave ose specifikacioni është bërë nga ekspertë vendorë, po e përsërisë. Kurse sa i përket metodës së tenderimit ne kemi vendosur jo për negociim të çmimeve, por për tender të hapur ndërkombëtar për me qenë më transparent dhe me ju ikur keqkuptimeve, si dhe me pasur konkurrencën e operatoreve për konkurrim lidhur me specifikacionin apo aparaturën e kërkuar nga ne. Kjo ka qenë arsyeja pse jemi përcaktuar për tender të hapur ndërkombëtar. Unë, si ministër i MSH-së, kam marrë garanci nga AHC se gjitha procedurat e prokurimit janë zhvilluar konform ligjeve të Austrisë, dhe sigurisht ju kemi besuar dhe për një arsye të tillë e kemi nënshkruar marrëveshjen.

Bekim Haxhiu, deputet- Faleminderit kryetare, të nderuar kolegë deputetë, i nderuar z. ministër dhe staf i ministrisë. Faleminderit ministër që ju keni përgjigjur ftesës së komisionit për të sqaruar këtë çështje që ka qenë temë dhe për të cilën temë qysh në seancën e vitit të kaluar unë, si deputet, e kam ngritur si çështje. Janë disa çështje që dëshirojmë që t'i diskutojmë me ju së bashku me deputetët e komisionit dhe sigurisht se edhe qytetarët dhe mediat janë të interesuar për një gjë të tillë. Fillimisht në projekt- buxhetin e vitit të kaluar ka qenë i planifikuar ky projekt, por ka qenë i planifikuar për sallën hibride. Unë e kam kundërshtuar atëherë se rrethanat e tanishme të shëndetësisë kosovare, modernizimi mund të jetë fjalë e mirë dhe tingëllon bukur, por gjendja aktuale në shëndetësinë kosovare nuk mund të flitet për një modernizim, ku ne kemi probleme substanciale funksionale në sektorin e shëndetësisë, përderisa kemi probleme në funksionimin e sistemit shëndetësor. Mendoj që fjala modernizim është diçka e lakmueshme, por për momentin e pa arritshme. Keni mbrojtur atëherë si projekt dhe është mirë me ju sqaruar qytetarëve për një vit pse nuk u realizua projekti i sallës hibride për arsye se të gjitha këto pajisje që planifikoni me i blerë keni planifikuar me këtë marrëveshje, janë pjesë integrale e sallës hibride. Pra, është mirë që ta njoftoni opinionin pse është hequr dorë nga salla hibride, pse nuk është realizuar salla hibride sipas buxhetit 2015/2016? Ndryshimi është bërë nga ana e juaj, kundërshtimi i im për këtë marrëveshje ka qenë se pas përfundimit të tenderit, ku vlera ka qenë 2.1 milionë € dhe kur ka ardhur marrëveshja që të ratifikohet vlera ka qenë 2.6 milionë €, pra është bërë rritja e vlerës për 500 000 €. Unë ju kam pyetur pse është rritur vlera 500 000 € dhe pse është rritur pas përfundimit të procedurës së tenderimit dhe kjo ka qenë ajo arsyeja pse unë nuk e kam votuar këtë marrëveshje duke e falënderuar qeverinë austriake dhe bankën për mbështetjen e vazhdueshme. Prandaj nuk mendoj se mos votimi i marrëveshjes do të ndikojë në raportet tona shtetërore diplomatike. Kjo nuk do të ndodhë për arsye se as qeveria e Austrisë nuk është e interesuar, sepse kjo është diçka që nuk është mirë të kalojë, por është mirë të korrigjohet. MSH në këtë prioritet për shpenzim të mjeteve nuk ia keni qëlluar, ky është mendimi im. Mendoj se kemi shumë probleme ma të mëdha se sa modernizimi i kardiologjisë. Kardiologjia sot nuk po vuan për aparatura. I nderuar z. ministër kardiologjia sot po vuan për furnizim, kardiologjia invazive sot vuan për furnizim dhe lista e pritjes, siç e dini ju dhe unë, është 7 muaj. Pra, nëse sot lajmërohesh në kardiologji invazive për koronarografi duhesh të presësh 7 muaj për arsye se tani e dy muaj kanë probleme në furnizim dhe problemet janë edhe menaxhere, këtu mendoj se edhe ju jeni të informuar ashtu siç jam edhe unë.

Para dy viteve lista e pritjes ka qenë një javore, ajo listë e pritjes sot është zgjatur 7 muaj dhe kjo paraqet disa probleme të tjera. Mendoj se problemi i përcaktimit të prioriteteve nga MSH nuk është në rregull, MSH do duhej të përcaktohej se ne sot kemi të sëmurë që presin me muaj të tërë për të marrë terapi në Onkologji, pastaj i kemi sallat e Kirurgjisë në gjendje të mjerueshme dhe në asnjë nga këto salla nuk është intervenuar me këtë buxhet që do duhej të paktën të intervenohej me këtë buxhet. Ju e dini që ka pasur raste që gjatë operacionit ka ra pluhuri nga plafoni, kjo paraqet gjendje të mjerueshme të sallave. Dhe të merren masa që Kardiologjia dhe Kardiologjia Invazive të jetë funksionale për arsye se aparatura ekziston dhe ky është një dublikim i aparaturave edhe po ashtu edhe angiografet ekzistojnë në kuadër të QKUK-së, po ashtu kryhet angioCT-ja. Të gjitha këto shërbime mund të ofrohen pa i shpenzuar këto mjete 2.6 milionë € esenca është që keni thënie se kredia është rritur për 500 000 € për shkak të nevojës që është kërkuar për izolimin e hapësirës Kardiologjisë invazive, ku do të vendosën këto aparatura dhe për lyrje të kësaj hapësirë mendoj që është shumë një hapësirë e tillë ku do të vendosën aparaturat të investohet 0.5 milion €, ku me këtë shumë do të ndërtonim një objekt të ri. Hapësira për vendosjen e këtyre aparaturave nuk merr me shumë se 100 m² dhe me 5000 € m² me izoluar dhe me lyer, mendoje me këtë shumë do ta bënim edhe në ari, e jo me material ndërtimor. Faleminderit!

Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë- Faleminderit z. deputet, fillimisht dëshiroj me ditur se a jeni për sallën hibride apo kundër sallës? Kur e keni ngritur këtë çështje në Kuvend unë nuk e kam mbrojtur projektin e sallës hibride, por kam thënë që nuk do ta bëjmë sallën hibride dhe kemi thënë se këto mjete do t'i shfrytëzojmë për çështje të tjera. Dhe ju kemi njoftuar pse ne, si MSH, kemi hequr dorë nga salla hibride, pra kemi hequr dorë në fund të vitit 2014, dhe gjatë bisedave me ambasadën e Austrisë, si dhe me ekspertët kemi vendosur që me këto mjete të bëjmë blerjen e aparaturës tjetër dhe jo në sallë hibride. Dhe nuk ka kushtuar kjo aparaturë që është në specifikacion 4.6 milionë €, sa ka qenë për sallën hibride. Ne me 2.6 milionë € po i blejmë disa aparatura të cilat nuk janë të koncentruar në një vend, por e modernizojnë intensiven e kardiologjisë dhe monitorimin, ka ultrazë, është qendra për monitorimin e vlerësimin e ultrazëve - qendra e punës është EKG, ekstra-korporalja, si dhe angioCT. Nuk është e vërtetë që kemi probleme në këta dy muaj me furnizim me barna të kardiologjisë. Ne e dimë ku është qëllimi, mirëpo prej gushtit të vitit të kaluar, pra nëse është fjala të kontrastet nuk ka kontrast për furnizim. Dhe gjithmonë është bërë zgjidhja me blerje urgjente dhe furnizimi nga spitalet rajonale. Ne jemi në fazën dhe shpresoj se tashmë është kontraktuar, apo është në fazën finale kontraktimi për furnizim me kontrast dhe angiografitë janë duke u bërë. Mirëpo është mirë që ju të theksoni se edhe gjatë vitit të kaluar edhe vitet tjera, që për arsye të defektit në angiografitë i cili është i vjetër dhe shumë i përdorur, kemi pasur periudha ku nuk është bërë angiografia fare. Neve, si MSH, na ka kushtuar shumë më shumë se sa ne për ta blerë një angiografi të re. Fatmirësisht Kardiokirurgjinë e kemi funksionale dhe kardiologjinë ta bëjmë me ofrim të shërbimeve 24 orë, sot shërbimet e kardiologjisë invazive jepen vetëm në ndërrimin e paradites. Pra, po ju njoftoj se unë sot, si ministër, kam nënshkruar 6 urgjenca, infarkte akute miokardit, të shkojnë jashtë për arsye të mos funksionimit të kardiokirurgjisë invazive dhe blerja e kësaj aparature mundëson që ne edhe me rekrutimin e një stafi diku 4 deri 5 teknikë që do të aftësohen për t'i asistuar mjekeve, kardiologëve invazivë do të mundësohet funksionalizimi i kardiologjisë invazive. Gjithashtu ne kemi paraparë edhe tarifa motivuese shtesë në pagesë për kardiologët invazivë dhe për kardiokirurgët. Pra, kjo do të rregullohet me një vendim të Qeverisë, që besoj se do të nxjerrët shumë shpejt që këta profesionistë të shërbejnë në

institucionet tona publike. Subvencionimi në paga do të bëhet vetëm kur do të funksionalizohen shërbimet 24 orë.

Nuk është fjala vetëm për lyerje të ambienteve, por për shtim apo dublifikim të hapësirave, shtim 100 % të garancisë prej 12 muajve në 24 muaj, është fjala për trajnim të ekspertëve në Vjenë dhe është fjala për rregullimin ma të mirë të mundshme me norma ndërkombëtare të mbrojtjes nga rrezatimi. Kjo vlerë prej 490 000 € saktë do t'i nënshtrohet aneksit 23.6 të marrëveshjes që parasheh që do t'i nënshtrohet vlerësimit juridik nga Qeveria e Kosovës – MSH nëse vlerësohet se është konform legjislacionit do të shpenzohet kjo vlerë, nëse jo atëherë ne do t'i shpenzojmë vetëm 2.1 milionë €, pra blerjen dhe montimin e aparaturës.

Bekim Haxhiu, deputet- Faleminderit ministër për këto sqarime, është fakt ajo çka është aktuale në shëndetësi është ashtu siç e thashë unë me plot probleme. Pra, ju po mendoni që të rregulloni, mirëpo për momentin pacientët po përballën me kushte shumë të vështira e pritje të gjata. Në specifikacionin nr. 1 të tenderit të shpallur nga AHC, aparatura i është përgatitur që të jetë e Philips-it dhe ka eliminuar konkurrencën pasi që në një mënyrë ka qenë e përcaktuar se kush do të jetë përfituesi në specifikim është emri i mbrojtur Shfarcer, që në fakt është një pjesë e marrëveshjes ekskluzive e kompanisë Philips. Në bazë të asaj që pyeti kolegu për çmimet e tregut, maksimumi i çmimit të këtyre aparaturave, nëse blihen diku tjetër, është diku 1.2 milion €. Ministër, unë jam i interesuar që marrëveshjen me Austrinë ta mbani, mirëpo të sillni për prioritetë e tjera të cilat janë në kuadër të shëndetësisë.

Hatim Baxhaku- Të nderuar deputetë, i nderuar z. ministër dhe ju të pranishëm. Ministri këto sqarimi i ka prezantuar edhe në kuvend kur është ngritur kjo çështje e shumë prej 500 000 €, pra që nuk janë vetëm për lyerjen e këtyre hapësirave, por për shtimin e hapësirave, izolim nga rrezatimi, shtimin e garancisë, si dhe aftësimi i stafit për përdorimin e këtyre aparaturave. Vetë fakti që pacientet po presin 7 muaj për angiografi flet nevoja për një angiograf të ri, sepse një angiograf mund të prishet në çdo moment dhe prishja e tij çrregullon krejt rendin e pritjes dhe ju stërzgjatët koha e pritjes. Është e vërtetë se ai angiograf është shumë i vjetër dhe shumë i përdorur, jam në dijeni se unë jam një doktor që punoj me pacientë, nuk jam doktor i zyrës, e di që çka do të thotë që të prishet për një javë CT, në Prizren në këtë rast e çrregullon punën për një muaj të tërë. Kështu që po edhe të kish funksionuar shumë mirë angiografi, po të blihet edhe një do të ishte shumë ma mirë sepse njëri prishet ose është në rregullim, puna nuk ndalet se punohet vetëm me njërin. Kështu që blerja e këtij angiografi nuk është aspak gabim, por është shumë i qëlluar. Sa i përket çmimeve unë nuk dua të flas, pasi që nuk jam ekspert i çmimeve, në Austri s'po besoj se ka pasur ndonjë dallaver me çmime. Sigurisht se këta ndoshta e kanë se kush e ofron aparaturën ma të mirë e jo ma të lirë, sikurse është te ne në procedurat e prokurimit. Ne, në Prizren, jemi dëmtuar disa herë për shkak se kemi blerë aparatura me çmim ma të lirë, kurse prodhimi apo kualiteti ka qenë shumë i dobët nga prodhues të dobët kinez, i cili s'ka funksionuar dy deri tre muaj. Ju faleminderit!

Fadil Beka- Përshëndetje për ministrin dhe stafin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ne të gjithë e dimë se shëndetësia ka shumë probleme, por të gjitha problemet nuk zgjidhen përnjëherë. Numri ma i madh i pacientëve që kanë nevojë për trajtim jashtë institucioneve publike kryesisht janë të sëmurit koronarë, pikërisht kjo po bëhet që këtyre pacientëve të ju krijohet mundësia që të trajtohen brenda vendit edhe në institucionet publike. Siç tha kolegu Baxhaku, mundësitë e Kosovës janë të tilla se

unë konsideroj se çdo kund t'i kemi nga dy aparatura në të njëjtën kohë. Ne me një koronaragraf ndodh që duke u ekzaminuar pacientin, ai prishet, koronarografi që është aty ai më të e vërtetë është i stërngarkuar dhe është një aparaturë që besoj shumë se nuk ka më në Evropë atij lloji, janë dalë prej përdorimit me sa e di unë. Është bërë shumë zhurmë rreth sallës hibride, më të thanë të drejtën sallë hibride nuk e besoj që ka diku në rajon. Salla hibride është fjala e fundit e atij organizimi, mirëpo salla hibride operacionet nuk i kryen vetë. Ne kemi pasur probleme për kuadër që nuk i kryejnë operacionet, e jo salla është mirë që është bërë një hap që kemi ekspertë kuadro që i kryejnë operacionet, intervenimet në zemër. Prandaj unë konsideroj që kjo marrëveshje është si gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që i kemi ratifikuar. Unë edhe atëherë i kam dhënë mbështetje edhe tash e mbështes, si marrëveshje bile në këtë rast pajtohem me kolegen që sa me shpejt të xhindet një mundësi për rikthim në Kuvend për ratifikim. Aparaturat në me sa i kemi vejtur janë të teknologjisë së fundit Siemensi, Philips dhe gjeneral elektrik, janë tri kompanitë me të fuqishme dhe janë kompani gjigande që prodhojnë këto aparatura konsideroj që nuk është bërë gabimi që është zgjedhur Philips, bile specialitet të Philips-it janë pikërisht ato aparatura që kanë për të ardhur. Unë kërkoj që të ratifikohet kjo marrëveshje, me ardhur këto pajisje, me ju afruar shërbime qytetarëve edhe ajo që e tha ministri është shumë me rëndësi që shërbimi me funksionuar 24 orë. Pra, nuk mundemi që të punojmë 24 orë pa pasur aparatura adekuate. Çështja e furnizimit me barna është çështje tjetër dhe nëse për ditë punohet nuk do të thotë se nuk ka furnizime, është shumë me rëndësi që të punohet 4 orë pasi që infarkti nuk të godet vetëm në orën 15, por të godet në çdo moment. Ju inkurajoj ju, si ministri, që më bërë çmos që shërbimi me afruar 24 orë, kurse për furnizimi është çështje tjetër, besoj se edhe ju e keni parasysh këtë gjë. Ju faleminderit!

Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë- Vetëm desha që të shtojë një koment, aparaturave që është paraparë që të blihet dhe është listuar në specifikacion në çmim prej 2.1 milionë €, ashtu siç tha deputeti z. Beka është fjala e fundit e teknologjisë edhe pajtohem plotësisht që ne jemi munduar që të bëjmë aparaturë të dyfishtë për pikat kyçe ku prishet sistemi dhe ku rrezikohet jeta e pacientit. Kur kemi negociuar me kardiokirurgët që të rikthehen dhe të punojnë në institucionet tona publike një nga shqetësimet e tyre ka qenë pikërisht aparatura rezervë, konkretisht një aparat ekstrakorporal ne e kemi paraparë që të blejmë të dytin. P. sh. : po të vendosim pacientin në operacioni dhe u prish aparati me çka të trajtojmë atë pacient? Ne nuk guxojmë të bëjmë aso politika të tilla që të rrezikojmë edhe pacientin edhe profesionalizmin e punëtorëve shëndetësorë. Nuk është fjala këtu që po blejmë angioCT dhe nuk kryhet angiografi është shumë ma shumë se sa angiografia, aparatin që do të blejmë. Është aparat që do të ketë nevojë që të trajnohen edhe ekspertë ma të mirë të përdorimit të teknologjisë dhe do të mbulojë edhe angiografin, por edhe shërbimet e tjera. Pra, duke blerë aparaturë moderne, duke siguruar ambiente të mira adekuate që të ruhen aparaturat në temperaturë konstante, duke aftësuar stafin, mbrojtjen e punëtorëve nga rrezatimi dhe pacientëve, ne mund të kërkojmë nga stafi shëndetësor që të bëjnë punë 24 orë. Ne kemi kërkesa dhe shqetësime të vazhdueshme nga kardiologjia invazive, stafi shëndetësor është i rrezikuar nga rrezatimi. Ne kemi bërë edhe matje që fatmirësisht nuk kanë dalë sa janë shqetësimet. Ne po planifikojmë, ashtu siç e kemi funksionalizuar kardiokirurgjinë dhe i kemi mbi 60 operacione me dy kardiokirurgë, ta bëjmë funksionale edhe kardiologjinë 24 orë shërbim. Në funksion të saj ne do të nxjerrim edhe vendimin për motivim i cili do të garantonte edhe motivim edhe furnizim të qëndrueshëm të këtyre njësive, që të mos ketë stenat të mos ketë kontrast. Për informimin tuaj edhe të publikut në sot e kemi furnizimin me barna dhe material i harxhuar në kujdesin parësor mbi 80 %

në klinikat e QKUK-së dhe spitalet e përgjithshme 70 % në Onkologji mbi 95 % plotësimin e nevojave me citostatik dhe shërbimit që jepen në klinikën e onkologjisë janë shërbime që nuk jepen në rajon, sa i përket afateve kohore të pritjes ose marrjes së terapisë. Ka një tendencë të krijimit të mungesës artificiale, mungesës së barnave në këtë gjë jemi duke e inspektuar përmes inspektoratit shëndetësor. Ju faleminderit!

Kryetarja- Ju faleminderit ministër, faleminderit kolegë për këtë çështje, besoj se u sqarua mjaft mirë. Në bazë të kësaj që u diskutua sot u pa shumë e nevojshme transparenca ndërmjet Komisionit dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Pra, ne, si komision, kemi nevojë që të njoftohemi në detaje jo vetëm për marrëveshje, por edhe çështje të tjera me rëndësi për shëndetësinë. Ndoshta të jemi edhe pjesë e vëzhgimit në disa procese që po ndodhin edhe kjo ministri pasi që ka shumë vërtetë për shërbimet shëndetësore. Njëra ndër vërejtjet tona ka qenë motivimi i këtij kuadri, si dhe afrimi i shërbimeve 24 orë. Ne gjatë vizitës që kemi realizuar në këtë sektor, në rajon subvencionohen apo motivohen me paga shtesë, përndryshe nuk mund të mbahen të angazhuar në sektorin publik me një pagë 700 €. Po ashtu ne kërkojmë transparençë në shqyrtimin e mundësisë së rikthimit të kësaj marrëveshje në Kuvend për ratifikim, jo ka qenë edhe ideja e këtij takimi që ne, si komision, edhe ju si ministri ta shqyrtojmë mundësinë që kjo marrëveshje të rikthehet sa më parë në Kuvend për ratifikim. Ju faleminderit!

- Raportimi i ministrit të Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani:

- **Memorandumi i Mirëkuptimit, midis Zyrës së Presidentit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, ofrimi i Shërbime shëndetësore falas për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës.**

Kryetarja- Atëherë po vazhdojmë me shqyrtimin e kësaj pike, Memorandumi i Mirëkuptimit, midis Zyrës së Presidentit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, afrimi i Shërbime shëndetësore falas për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës. Ne nuk jemi të informuar për këtë memorandum dhe jemi të interesuar që të njoftohemi. Atëherë ministër në pika të shkurtra një informatë për këtë çështje.

Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë- Ju faleminderit kryetare. Është e vërtetë që ne, si dy institucione, e kemi nënshkruar këtë Memorandum. Kjo ka qenë si kurorëzim të një aktiviteti që e ka bërë Presidentja e Kosovës, znj. Jahjaga me themelimin e Këshillit nacional për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës. Këto shërbime që parashihen në këtë memorandum janë shërbime që zakonisht MSH i ka ofruar për gjithë pacientet, por edhe për këtë kategori nuk ka diçka të veçantë parashihet që të sigurohen mjete dhe barna nga lista esenciale falas dhe shërbime tjera që do të lehtësojnë jetën e kësaj kategorie, parashihet edhe bashkëpunimi edhe me OJQ- të. Mirëpo nuk ka buxhet të veçantë që është ndarë ekstra për këtë çështje, janë kryesisht finalizimi i një pune që është bërë me vite ndërmjet nesh edhe Presidencës. Kryesisht është kërkuar edhe harmonizimi i legjislacionit dhe kjo kategori në të ardhmen të parashihen në ligjin për sigurimet shëndetësore që të lirohen nga mbledhja e premiumeve, këto janë disa çështje kryesore. Ne do të ju përcjellim këtë memorandum që ju të analizoni apo shqyrtoni.

Kryetarja- Ju faleminderit ministër dhe ju të pranishëm. Pasi të pranojmë edhe të shqyrtojmë këtë memorandume do të vlerësojmë se a kemi nevojë që të diskutojmë më tutje. Ministër ju faleminderit për këto sqarime apo informata.

3. Të ndryshme

Kryetarja – Po ju njoftoj se sot kemi takim grupi punues për nismën ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/l-054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë

Vendim

Për grupin punues të shtrohet drek pune.

Kryetarja – Ju falënderoj për kontributin tuaj!

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA